

UDHËZIM
Nr.4566, datë 27.6.2005

PËR DISA SHTESA DHE NDRYSHIME NË UDHËZIMIN NR. 8045, DATË 2.12.2004 TË
MINISTRIT TË DREJTËSISË “PËR FORMËN, PËRMBAJTJEN, KARAKTERISTIKAT
DHE RREGULLAT E PAJISJES DHE ADMINISTRIMIT TË VULAVE TË NOTERËVE”

Në mbështetje të nenit 102 pika 4 të Kushtetutës, të neneve 124 dhe 128 të ligjit nr. 8485, datë 12.5.1999 (i ndryshuar), të nenit 7 pika 2 të ligjit nr.8678, datë 14.5.2001 “Për organizimin dhe funksionimin e Ministrisë së Drejtësisë”, (i ndryshuar) dhe të nenit 17 të ligjit nr. 7829, datë 1.6.1994 “Për noterinë”, (i ndryshuar)

UDHËZOJ:

Në udhëzimin nr.8045, datë 2.12.2004 të Ministrisë së Drejtësisë “Për formën, përmbajtjen, karakteristikat dhe rregullat e pajisjes dhe administrimit të vulave të noterëve”, bëhen këto shtesa dhe ndryshime:

1. Pika 4 e udhëzimit nr. 8045, datë 2.12.2004 “Për formën, përmbajtjen, karakteristikat dhe rregullat e pajisjes dhe administrimit të vulave të noterëve”, ndryshohet dhe bëhet si më poshtë:

“4. Përgatitja e vulave bëhet nga subjekte shtetërore të specializuara dhe kur kjo nuk është e mundur nga subjekte private shqiptare ose të huaja, të cilat e ushtrojnë veprimtarinë e përgatitjes së vulave me leje të nxjerrë nga organet kompetente”.

2. Pika 5 e udhëzimit nr. 8045, datë 2.12.2004 “Për formën, përmbajtjen, karakteristikat dhe rregullat e pajisjes dhe administrimit të vulave të noterëve”, ndryshohet dhe bëhet si më poshtë:

“5. Personi i cili merr për herë të parë lejen për ushtrimin e profesionit të noterit, noteri që transferohet, noteri të cilit i janë dëmtuar vulat dhe noterit të cilit i kanë humbur vulat, i paraqesin kërkesën për vula Dhomës Kombëtare të Noterisë.

Kërkesa duhet të jetë e shoqëruar me konfirmimin e Ministrisë së Drejtësisë se personi lejohet të pajiset me vulat e noterit, si dhe me të dhënat e nevojshme për përgatitjen e vulave.

Në rastin e vulave të reja, për shkak se kanë humbur të mëparshmet, matrica e vulës së re duhet të ketë detyrimisht një vendosje të ndryshme topografike të mbishkrimeve të saj, që e bëjnë të dallueshme nga vula e mëparshme”.

3. Pika 6 e udhëzimit nr.8045, datë 2.12.2004 “Për formën, përmbajtjen, karakteristikat dhe rregullat e pajisjes dhe administrimit të vulave të noterëve”, ndryshohet dhe bëhet si më poshtë:

“6. Pasi janë përgatitur, vulat i dorëzohen përfaqësuesit të Dhomës Kombëtare të Noterisë në prani edhe të personit të ngarkuar nga Ministri i Drejtësisë. Vulat merren në dorëzim me procesverbal të firmosura nga të dy përfaqësuesit e përmendur sa më sipër dhe depozitohen për ruajtje pranë Ministrisë së Drejtësisë. Vulat ruhen dhe nuk përdoren deri në ceremoninë e betimit, kur do t'i dorëzohen noterit”.

4. Pika 8 e udhëzimit nr. 8045, datë 2.12.2004 “Për formën, përmbajtjen, karakteristikat dhe rregullat e pajisjes dhe administrimit të vulave të noterëve”, ndryshohet dhe bëhet si më poshtë:

“8. Procedurat e përgatitjes së vulave nga Dhoma Kombëtare e Noterisë duhet të përfundojnë brenda 40 ditëve nga dita e lëshimit të lejes së ushtrimit të profesionit të noterit nga Ministri i Drejtësisë.

Në rast të mosrespektimit të afatit të sipërpërmendur nga Dhoma Kombëtare e Noterisë, procesi i përgatitjes së vulave drejtohet dhe organizohet nga Ministria e Drejtësisë në përputhje me rregullat e parashikuara në këtë udhëzim”.

5. Pika 11 e udhëzimit nr.8045, datë 2.12.2004 “Për formën, përmbajtjen, karakteristikat dhe rregullat e pajisjes dhe administrimit të vulave të noterëve”, ndryshohet dhe bëhet si më poshtë:

“11. Për pajisjen me vulë mbahet një procesverbal, i cili nënshkruhet nga përfaqësuesi i Dhomës Kombëtare të Noterisë, drejtori i drejtorisë përgjegjëse për veprimtarinë e noterisë në Ministrinë e Drejtësisë dhe nga noteri. Procesverbali pasqyron kohën, vendin, emrin e pjesëmarrësve dhe faktin e marrjes së vulës në dorëzim nga noteri.

Procesverbali nënshkruhet nga personat e sipërpërmendur duke i dhënë një kopje të tij Dhomës Kombëtare të Noterisë dhe një kopje depozitohet në Ministrinë e Drejtësisë.

Drejtori i drejtorisë përgjegjëse për veprimtarinë e noterisë në Ministrinë e Drejtësisë kërkon nga personat të firmosin dhe të vulosin me vulat e reja në fletë të bardha format “A 4”, të cilat nevojiten për t’u depozituar në dosjen personale dhe për t’iu dërguar institucioneve të ndryshme shtetërore si model krahasues”.

Ky udhëzim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

MINISTRI I DREJTËSISË
Fatmir Xhafaj